

JORIDA TABAKU



Datëlindja: 01.07.1979

Vendlindja: Tiranë

Email: Jorida.Tabaku@parlament.al

Jetëshkrimi:

Është diplomuar me rezultate të shkëlqyera për menaxhim biznesi në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës. Ka kryer studimet pasuniversitare në shkollën e biznesit, Universiteti i Durham, Mbretëri e Bashkuar dhe në Universitetin e Nebraskës në SHBA. Ajo mban gradën “Doktore e Shkencave” në ekonomi.

Duke filluar nga 2002, znj. Tabaku ka punuar në pozicione si menaxhere projekti, konsulente kryesore pranë organizatave ndërkombëtare si USAID, UNESCO, Institute for Contemporary Studies, REPIM, SIFE. Pas përfundimit të studimeve, në vitet 2002-2009 ajo ka qenë lektore në Fakultetin e Ekonomisë. Ajo ka qenë e angazhuar si kërkuese kryesore në SDC dhe Graduate Institute for International Studies. Në vitet 2007-2009 znj. Tabaku ka ushtruar detyrën e koordinatores së projektit dhe konsulentës vendore pranë Universitetit të Tiranës/ Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë.

Znj. Tabaku ka mbajtur detyra të rëndësishme shtetërore. Në periudhën 2009-2011 ka ushtruar detyrën e zëvendësministres në Ministrinë e Integritimit Evropian. Në vitet 2011-2013, ajo ka mbajtur postin e zëvendës kryetares së Bashkisë Tiranë. Prej vitit 2013 deri në vitin 2019 ka qenë deputete e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ka qenë nismëtare e disa amendamenteve si për ligjin e taksave, ligjin e investimeve strategjike etj.

Ajo ka marrë pjesë në kurse trajnimi brenda dhe jashtë vendit. Znj. Tabaku ka botuar artikuj në revista akademike kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sipërmarrjes, qeverisjes së korporatave, financimin e institucioneve të arsimit të lartë, procesin e privatizimit, menaxhimin financiar publik, etj